



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTARES PËRGJEGJËSE**

Neni 1

Me këtë Vendim nënpunësja civile, Bukuriye Zejnullahu-Jashari Shefe e Sektorit për Mardhënie me Publikun, **CAKTOHET** Zyrtare Përgjegjës për menaxhimin me Platformën e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

E lartë cekura do të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në bazë të dispozitave të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Neni 3

1. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Bukuriye Zejnullahu-Jashari Shefe e Sektorit për Mardhënie me Publikun.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.112/02-30571 i datës 14.06.2022.

1Nr. 112/02-11352

Lipjan, më 22.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, shkresës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të datës 31.01.2024, Kryetari Komunës merr:

VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS

I. Me këtë Vendimi, **CAKTOHET Burim Gashi** - Shef i Sektorit për Administratë të Përgjithshme në kuadër të Drejtoratit për Administratë i caktohet detyra shtesë si Zyrtar përgjegjës nga Komuna për monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit pas hyrjes në fuqi të udhëtimit pa viza.

II. Detyrat shtesë si Zyrtar për monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit pas hyrjes në fuqi të udhëtimit pa viza, i caktohen të bën monitorimin e trendit të lëvizjeve migratore, pas hyrjes në fuqi të udhëtimit pa viza për qytetarët e Komunës së Lipjanit, Zyrtari përgjegjës do të shërbej si pik kontaktuese për Ministrin përkatëse lidhur me të dhënat e lëvizjes së qytetarëve të Lipjanit.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet zyrtari Burim Gashi, Drejtorati për Administratë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

1Nr. 020/02-6084
Lipjan, më 06.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligji nr. 08/l-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT KOMUNAL TË PERFORMANCËS DHE ZYRTARËVE KOMUNALË PËR PERFORMANCË PËR FUSHAT E CAKTUARA NË KOMUNËN E LIPJANIT PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023

Neni 1 Përbërja

I.Me këtë Vendim, **SHEMSI AZEMI**, në pozicionin e punës Shef i sektorit për tatim në pronë, emërohet **Koordinator Komunal për performancë**, ndërsa **zyrtarë komunalë për performancë për fushat e caktuara** emërohen zyrtarët si vijon:

1. **BURIM GASHI** (fushën e shërbimeve publike administrative)
2. **BUKURIJE ZEJNULLAHU** (fushën e transparences komunale dhe fushën e përgjegjshmërisë komunale)
3. **ALBERT MUSTAFA** (fushën për të drejtat e njeriut, shërbime sociale dhe familjare)
4. **RAMIZ GASHI** (fushën e kulturës, rinisë dhe sportit)
5. **GAFURR HETEMI** (fushën e menaxhimit të fatkeqësive)
6. **HANUSHE BERISHA** (fushën e planifikimit hapësinor komunal, fushën e hapësirave publike komunale dhe fushën e mbrojtjes së mjedisit)
7. **FATBARDHA SHURDHIQI** (fushën e infrastrukturës rrugore lokale, fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, fushën e kanalizimit dhe higjienës publike dhe fushën e menaxhimit të mbeturinave)
8. **SALIHE MAREVCI** (fushën e transportit publik komunal dhe fushën e hapësirave për parkim publik)
9. **HASAN LUMA** (fushën e përfaqësimit gjinor)
10. **BRAHIM DURIQI** (fushën e arsimit parauniversitar)
11. **IZER SINANI** (fushën e kujdesit primar shëndetësor)
12. **LINDA SHAHINI** (fushën e integritimit dhe zhvillimit)

II. Kordinatori dhe zyrtarët komunalë për performance i kanë të përsëhkruara në mënyrë të përgjithshme detyrat e punës në nenet vijuese 2 dhe 3 ndërsa me këtë Vendim obligohen të hartojnë raportin e performancës vetëm për vitin 2023 me mundësi vazhdimi

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit Komunal për Performancë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit komunal për performancë janë:

- Bashkërendon punën e përgjithshme në Komunë për administrimin e sistemit për matjen e performancës,
- Propozon listën e zyrtarëve komunal për performancë(zyrtarëve përgjegjës) për miratim nga kryetari i Komunës dhe udhëheqë punën e tyre në procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave (MVRDH),
- Harton planin e veprimit dhe organizon takime pune me zyrtarët komunal të performancës (ZKP) për metodologjinë e zbatimit të tij për MVRDH në sistem,
- Monitoron procesin e MVRDH në sistem dhe jep udhëzime profesionale ZKP gjatë MVRDH sipas nevojë,
- Bashkërendon punën sipas, nevojë, me drejtoritë përkatëse nëpërmjet drejtorit të administratës,
- Bën verifikimin e të dhënave të raportuara nga ZKP sipas një orari përkatës gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 14 shkurt të vitit vijues.
- Përgatitë të dhënat e verifikuara dhe i dërgon për miratim tek kryetari i komunës nëpërmjet drejtorit të administratës deri me 21 janar të vitit vijues për vitin përkatës të raportimit. Në të njëjtën kohë bën verifikimin e të dhënave, nëpërmjet ZKP, nëse kryetari kërkon për shkak të dyshimeve eventuale në saktësinë e tyre,
- Sipas nevojë, bën raportimin e të dhënave të miratuara nga kryetari kur kjo nuk bëhet automatikisht nëpërmjet sistemit,
- Bën arkivimin e të dhënave të miratuara nga kryetari i komunës në kopje fizike në arkivën e komunës apo në arkivën zyrtare të KKP. Një kopje e miratuar nga kryetari i komunës i të dhënave arkivohet në mënyrë automatike nga programi elektronik në bazën e të dhënave në kompjuterin e KKP, të kryetarit të kryetarit të komunës dhe në MAPL- zyrtari përgjegjës për menaxhimin e të dhënave në DPK.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë janë:

- Harton planin për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për fushën përkatëse i ngarkuar nga kryetari i komunës , mbi bazën e kërkesave të KKP.
- Mbledhë, verifikon dhe raporton apo futë të dhëna në sistem gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 20 janar të vitit vijues.
- Kujdeset që para futjes së të dhënave në sitem, ta verifikojë saktësinë e të dhënës duke u bazuar vetëm në burimin zyrtarë të të dhënave përkatëse dhe bazuar në dokumente përfundimtare zyrtare, që d.m.th në dokumente të miratuara nga organet përgjegjëse të komunës, të protokoluara dhe me datën përkatëse të protokolimit apo të miratimit, varësisht nga lloji i dokumentit zyrtar.

- Bashkërendon dhe bashkëpunon me përgjegjësitë e njësive përkatëse ku punon dhe prej ku i merr të dhënat dhe me KKP.
- Raporton të dhënat e verifikuara tek KKP, në kopje fizike, kur kjo nuk bëhet në mënyrë automatike nga program elektronik i SMPK. Është përgjegjësi kryesor për saktësinë e të dhënave të raportuara në komunë për SMPK.

Neni 4 Hyrja në fuqi


Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet MAPL, Koordinatori komunal për performancë dhe zyrtarët komunal për performancë të cekur më lartë.

1Nr. 112/02-7472

Lipjan, më 07.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft-Statutit të QKMF-së së Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kryesues,
2. Agim Krasniqi, Drejtor i QKMF-së, zëvendës kryesues,
3. Dr. Mirjeta Cakolli, QKMF, anëtare,
4. Dr. Luftim Bresa, QKMF, anëtar,
5. Dr. Izer Sinani, QKMF, anëtar,
6. Dr. Gazmend Qerkini, anëtar,
7. Dr. Besnik Rashiti, anëtar,
8. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
9. Flora Budakova, QKMF, anëtare
10. Taibe Zogjani, QKMF, anëtare
11. Islam Kaleshi, Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtar dhe
12. Agim Murtezi, Këshilli i Pacienteve, anëtar

Neni 2 Detyrat e grupit punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin Draft - Statutit të QKMF-së të Komunës së Lipjanit. Grupi punues do të bëjë hartimin e Draftit të Statutit të QKMF-së të Komunës së Lipjani duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi më së largu deri me datën 29.02.2024.

Neni 3 Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues.

1Nr. 020/04-7633
Lipjan, më 08.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-7064 e datës 06.02.2024, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-7064 e datës 06.02.2024 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari për ndarjen e frezave për traktor për vitin 2024, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastruktur, Kryesuese
2. Hazbi Ademi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Merita Zeqiri Magashi, Drejtorati për Infrastruktur, anëtare

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për fermerë përkatësisht për freza për traktor për vitin 2024 të cilët kanë aplikuar sipas shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-7064 e datës 06.02.2024 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-7064 e datës 06.02.2024.
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

Neni 3

Hyrja në fuqi


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-10968

Lipjan, 21.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 dhe nenit 6 dhe 8 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.345/02-33605 e datës 30.06.2023, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË OPERATORËVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE
TAKSI DHE VERIFIKIMIN E AUTOMJETEVE

Neni 1

Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë për transportin e udhëtarëve me automjete taksi dhe verifikimin e automjeteve, (në vazhdim të tekstit Komisioni) të cilët kanë aplikuar sipas Njoftimit publik 13Nr.-346-02-5555 të datës 29.01.2024, në përbërje si vijon:

1. Daut Reçica, Kryesues
2. Salihe Marevci, anëtare
3. Rafete Retkoceri, anëtare
4. Rrahman Olluri, anëtar
5. Bujar Curri, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve sipas njoftimit të cekur publik, në afat prej 45 dite nga dita e pranimit të vendimit për formimin e komisionit, shqyrton aplikacionet, verifikon automjetet dhe harton Raportin me listën e operatorëve të cilët i plotësojnë kushtet për dhënie të Licencës, të cilin ia dërgon Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim
2. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do të kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-4706
Lipjan, më 05.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT –PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR
BARAZI GJINORE

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft –Plani Lokal i Veprimit për Barazi gjinore (2024-2026).

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft- Planit Lokal të Veprimit për Barazi gjinore (2024-2026) ose në email adresën diamant.bytyqi@rks-gov.net, më së largu me datë 08.03.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 016/01-10975
Lipjan, më 21.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **11,760.00€**, (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqindë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-6323 e datës 01.02.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 42 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin janar të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast $42 \times 280 = 11,760.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-6323
Lipjan, më 02.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Memorandumit të Bashkëpunimit Nr 5070 të 05.12.2023 në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministris së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës së Lipjanit, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim, themelohet Komisioni për procedurën e dorëzimit të dosjëve të stafit të personelit pyjor të Komunës së Lipjanit dhe pranim dorëzimi i inventarit dhe asetëve të stafit pyjor nga Komuna në Agjencin Pyjore të Kosovës (APK), në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesues
2. Adelina Sahiti-Rexhepi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa , anëtare
3. Rizvan Hoxha, Sektori për personel-Zyra e kryetarit të Komunës, anëtar

Neni 2 Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë percjelljen e procedurës së dorëzimit të dosjëve të stafit të personelit pyjor dhe pranim dorëzimin i inventarit dhe asetëve të stafit pyjore nga Komuna në Agjencin Pyjore të Kosovës (APK), sipas Memorandumit të Bashkëpunimit Nr. 5070 të 05.12.2023, në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministris së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës së Lipjanit në bashkëpunim me Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Komisionin e formuar nga Agjencioni Pyjori i Kosovës.

Neni 3 Zbatimi

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, Drejtorati për Buxhet dhe Financa si dhe Sektori për Personel.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen, kryesuesi, anëtarët e komisionit dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

INr. 020/04-6628
Lipjan, 02.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW) me Nr.15-400/01-5663 të datës 26.01.2024, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) si dhe Aneks Marrëveshjes nr.01-320/01-66307 e datës 01.12.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 50.024.00 € (pesëdhjetë mijë euro e njëzet e katër cent), për të vepruar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW) me Nr.15-400/01-5663 të datës 26.01.2024.

2.Ndarja e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së tërësishme të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) me të cilën Komuna e Lipjanit do të participojë 43.87% të vlerës totale përkatësisht kryerjen e obligimeve për pjesën e dytë apo 50% të obligimeve të mbetura.

Neni 2

Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW) do ti raportoj me shkrim Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, lidhur me veprimet e ndërmarra konform dispozitave të Marrëveshjes ku përfshihet Raporti financiar lidhur me mjetet e shpenzuara dhe arsytimi i tyre me fatura dhe dokumentacion tjetër përkatës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2024 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare nr 1708200008014285 në NLB Banka të Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW).

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-8028
Lipjan, më 09.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Vendimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës të datës 23.09.2020, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 8640,75 € (tetë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë euro e shtatëdhjetë e pesë cent), për pagesën e anëtarësisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës në pajtim me Vendimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës – AKK të datës 23.09.2020, Njoftimit të AKK për kodin ekonomik dhe faturës nr:17/24 të datës 01.02.2024.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, kategoria ekonomike – mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Administratë në xhirollogarinë bankare nr.1901586841031197 në Bankën Kombëtare Tregtare BKT.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-7900
Lipjan, më 09.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT –PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI I KOMUNËS SË LIPJANIT (2024-2026)

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft –Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali i Komunës së Lipjanit (2024-2026).

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft- Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali i Komunës së Lipjanit (2024-2026) ose në email adresën lidija.jovanovic@rks-gov.net, më së largu me datë 23.02.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 016/01-7652
Lipjan, më 08.02.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

